



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 55/19
Prishtinë, më 26.06.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Fikrim Damka, Blerim Kuçi dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontic, Arbërie Nagavci dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Osman Vishaj- kryetar nga KRPP; Ergin Kala - anëtar i bordit nga KRPP, Agron Ibishi- nga KRPP, Ramadan Gashi – Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Raif Preteni – Drejtor i Autoritetin Rregullativ për Shërbimet e Ujit, Ramiz Krasniqi – Drejtor i Financave në Autoritetin Rregullativ për Shërbimet e Ujit, Shkëlqim Xhema - auditor nga ZKA, Astrit Bllaca - auditor nga ZKA.

Pjesëmarrë tjerë prezent: Violeta Smajlaj- auditore nga ZKA; Saranda Baraliu- auditore nga ZKA; Shpresa Sogojeva- MBNJ-AKKVP; Fidan Cerkini- nga USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli, Doruntina Pireva- Praktikante, Sofie Tahiri- Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 12.06.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Ndihme Juridike Falas për vitin 2018;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2018;**
- 6. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 12.06.2019

Kryetari: Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 12.06.2019, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurorimit Publik për vitin 2018

Kryetari: ia kalojë fjalën Kryetarit të KRPP-së, që të prezantojë raportin e punës për vitin 2018.

Osman Vishaj: Gjatë vitit 2018 janë evidentuar 165 autoritete kontraktuese që kanë kryer prokurimin, ndërsa 16 autoritete kontraktuese i kanë kryer agjencionet nën prokurorim publik. Në bazë të ligjit për prokurim publik, autoritetet kontraktuese që kanë pasur më pak se 50 punonjës, prokurimet i ka kryer AQP-ja.

Bazuar në raportet e kërkuara nga autoritetet kontraktuese në gjithë Kosovën gjatë 2018 janë nënshkruar 12 mijë e 412 kontrata publike duke përfshirë gjitha llojet dhe vlerat e kontratave. Ndër të arriturat kryesore janë përdorimi i procedurës së hapur në prokurimin publik, zvogëlimi i procedurës së negociuar të njoftimeve prokurimtare dhe funksionimi i sistemit elektronik që ka mundur rritjen e transparencës. Tregues më të rëndësishëm që pasqyrojnë trendin e zhvillimit të prokurimit janë rritja e pjesëmarrjes së vlerës së kontratave të nënshkruara për punë.

Gjatë vitit 2016 ishte 41%, 2017 arrin në 52.96% për pjesëmarrje, 2018 është 56.5%. në raport me furnizime që ishin 28.79% ndërsa shërbime 14,62%. Rritja e pjesëmarrjes së vlerave të kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë 2016 ishin 84,55%, 2017 - 87%, 2018 - 88.56%. Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar gjatë 2018 ishte 8,18%. Numri mesatar i ofertave është 5% apo 5 veta për një tender. Pjesëmarrje e kontratave të nënshkruara sipas kriterëve për dhënien e çmimit ekonomik është më e favorshme në vitin 2018 ishte 0.98%, 2016 ishte 0.62%, 2017 ishte 1.33% dhe shihet një zvogëlim i dukshëm.

Zbatimi dhe funksionimi i plotë i sistemit elektronik për të gjitha procedurat e prokurimit shënohet si arritje më e madhe gjatë vitit të fundit në funksion të rritjes së transparencës dhe efikasitetit me prokurim publik.

Gjatë vitit 2018 si aktivitete kryesore të evidentuara në përdorimin e sistemeve të prokurimit elektronik të gjitha prokurimet në vlera mbi 1000 euro zhvillohen përmes kësaj platforme. 6.000 është numri i operatorëve ekonomik të regjistruar, të cilat përdorin platformën në mënyrë aktive, numri i të gjitha përdoruesve të regjistruar ka arritur në 10.000 dhe 31.000 publikime janë bërë mes platformës elektronike gjatë 2018. Nga data 15 korrik i 2018 për të gjitha prokurimet e centralizuara nga AQP, dorëzimi i ofertës është bërë vetëm në formë elektronike. Në janar 2019 ka filluar të zhvillohet sistemi elektronik për gjitha procedurat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogëla. Nga 1 janari nuk kemi dorëzim të ofertave në mënyrë fizike, vetëm elektronike.

Vëzhguesit ose raportuesit që ishin për KRPP-në, ka raportuar se është një agjenci e pavarur, rregullative, kompetente për zhvillim të përgjithshëm dhe zbatim të prokurimit publik, dhënien e rekomandimeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurim publik dhe akteve nënligjore, përgatit dhe shpërndan manuale dhe udhëzuese për prokurim evropian publik, dokumente standarde. Ajo është përgjegjëse për certifikim të profesionistëve të prokurimit.

Nuk janë raportuar probleme specifike lidhur me përdorimin e sistemit elektronik edhe pse jo të gjitha funksionet e tij janë duke u përdorur në mënyrë të plotë.

Kryetari: Sipas raportit tuaj, Departamenti për Monitorim dhe Mbikëqyrje ka raportuar se u kanë dhënë vërejtje 11 zyrtarëve të prokurimit, pas vërejtjeve a ka edhe raste të pezullimit apo revokimit të licencës të ndonjë zyrtari për shkaqe të shkeljes? E dyta, ka pasur rënie të vlerës sipas burimit të financimeve në faqen 24 në vlerën e kontratave nga donacionet ka rënë në mënyrë drastike prej 10.3 milionë euro në 300 mijë euro, gati për 10 milionë euro rënie. Çfarë është roli dhe përfshirja e autoriteteve kontraktuese në zhvillimin e procedurave për projekte të financuara nga donatorë? Përdorimi i procedurës së negociuar, vlera e përgjithshme e kontratave ka shënuar rritje prej 42 milionë në 51 milionë dhe duke pasur parasysh se kjo procedurë shihet më pak transparente, pse po ndodh një çështje e tillë dhe mungesa më e madhe e rritjes së procedurave të tilla ka ndodhur brenda ndërmarrjeve publike? Shqetësuese është edhe vlera e aneks kontratave, që arrijnë shumën 9.4 milionë dhe janë më të larta për 5 milionë krahasuar me vitin e ardhshëm. Pra këto aneks kontrata po kryhen dhe po lihen si dyshim për shkak të vonimit dhe po rrëzon këto kontrata ku po ka edhe pengesa, a duhet diçka të ndërrohet për shkak të tyre?

Blerim Kuçi: Ju përgëzoj për transparencën sipas formës elektronike dhe përdorimin e E-prokurimit, që është një avancim i madh edhe pse nuk i dihen ende defektet, është një transparencë e cila vërehet. Ajo që na shqetëson është avanci në çështjet e hapura të prokurimit. Mendimi im, Zyrat e Prokurimit nuk janë duke i kuptuar disa çështje se kur të përdoren dhe si. OSHP, KRPP dhe zyrat tjera të prokurimit nuk funksionojnë si duhet. A keni mundësi ju dhe a u takon me e rregullu dhe me i paraqit zyrtarët për trajnimin e kësaj forme të prokurimit. Poashtu në kuadër të Komisionit a keni ndonjë ide për çështjen e ligjit, unë e di që ligji veçse ka filluar në këto procedura, a jeni ju të informuar në këtë çështje?

Mërgim Lushtaku: Shqetësimi më i madh është tek ligji i prokurimit apo zbatueshmëria e ligjit për projektet që janë të miratuara me Buxhetin e Kosovës. Problem më të madh kemi pastaj me mbikëqyrje dhe implementim të këtyre projekteve. Cilat janë pikat ku mund të ndryshohen problemet më të mëdha gjatë këtyre viteve, ose rastet kur bizneset që kanë fituar tenderë dhe nuk janë përfillur, realisht është dashur të futen në listë të zezë nëse kanë lidhje me x institucionin!. Automatikisht do të duhej që me ligj të rregullohet që në rast të moszbatimit të hyjë në listën e zezë pa ndërhyrje. Për shkak të planifikimit të keq, mospërfilljes së kontratës, projekti po rezulton që të planifikohen edhe 20 vite dhe të mbeten në kodin buxhetor. Cilat janë mundësitë e ndryshimit të këtij ligji dhe pastaj ne si Komision do të bënim punën tonë?

Ali Lajçi: Në këtë drejtim rekomandimet të divizionit të prokurimit të sqarohen pak më detajisht. Pra, cilat rekomandime bëhen ndaj këtyre divizioneve, ose kontrata të negociuara edhe te institucionet në mënyrë të veçantë me për cilat projekte. Çka mund të themi është se këto rekomandime të divizioneve të shprehen në mënyrë më të detajuar sepse kjo duhet të rrisë çështjen e menaxhimit të performancës. Edhe çështjet tjera që shihen si më shqetësuese si rënia e buxhetit.

Safete Hadergjonaj: Shumë çështje që kanë qenë problematike gjatë viteve kanë filluar të ulen. Më herët ka pasur projekte dhe kontrata më shumë të negociuara dhe numri i tyre ka rënë, por sot e tutje janë zakonisht të negociueshme në Korporatën Energjetike të Kosovës, mua më intereson të dijë se a është e domosdoshme që Korporata Energjetike e Kosovës të shkojë sipas kësaj forme në bazë të kushteve të punës? Sipas një mendimi tuaj profesional, çfarë do të bënit ju me ndihmën e Komisionit tonë për monitorim e zbatimit të kontratave për projektet afatgjate, përkatësisht për ato objekte që ndërtohen dhe të cilat akoma pa hy në ato në funksion diçka apo dëmtohen menjëherë. A mundeni që me ligj me mundësu brenda një kohe me dhënë llogari mbi ata që marrin përsipër këto kontrata ose të jepni një shembull të mirë të ndonjë shteti tjetër që e bën njëfarë monitorimi të zbatueshëm se si po ndodhin punët, si po funksionojnë projektet pas finalizimit të tyre. Pra, të bëhet një monitorim i realizimit të

kontratës pas përfundimit të projektit për të parë përmbushjen e kushteve të përcaktuara me ato kontrata?

Osman Vishaj: Si pikë më e dobët në Kosovë është planifikimi i menaxhimit të kontratave. Ekziston një modul për monitorimin e kontratave, por problemi është edhe me zbatimin e atij moduli që ka nevojë për rishikim. Është duke u përgatitur plotësim-ndryshimi i ligjit të prokurimit, e kemi përgatitur koncept-dokumentin dhe jemi në përfundim. Në gjitha këto pika që u prekën janë trajtuar në koncept-dokument, sidomos tek ajo e katërta për punëtorët, dhe jemi në trajtim të ankesave për një zyrtar që punon aty dhe nuk merret me punë sepse ata kanë shumë procedura të prokurimit deri 50-60 mijë dhe u vjen mund. Po ashtu në koncept-dokument është trajtuar edhe çështja e prokurimeve të centralizuara për ato agjencionet me pak se 50 punëtorë, pasi që kjo ka paraqitur problem për disa agjencitë të tilla dhe vlerësimet janë që aktivitetet e prokurimit të kryhen vetë nga ato agjenci. Në një ndërmarrje publike dy vërejtje të punës kemi lëshuar për zyrtarë të prokurimit.

Kryetari: Këto vërejtje që jepen, a janë të përsëritshme dhe sa vërejtje jepen?

Agron Ibishi: Këto janë vërejtje të fundit dhe ipen sipas natyrës, rregullues si të varura apo të fundit. Nga 11 vërejtjet dy janë të fundit, 1 e varur. Rreth vlerës së donacioneve ky ndryshim i vlerës ka ndodhur si shkak që në aspektet e negociuara ka pasur rënie dhe një vlerë të rritshme. Janë arsyet që shpenzimet buxhetore për 2018, kemi rreth 37% të totalit të buxhetit të shpenzimeve për zyrat e prokurimit se vitin e kaluar për 2017 në rritje nga 459, 631 milionë është proporcionalja.

Kemi rritje të aneks kontratave, dhe për ato nuk ka çfarë të bëhet sepse ligji ia mundëson që deri 10% të lidhin aneks kontrata.

Përdorimi i kriterit të çmimit të dhënies së kontratës, prej vitit 2008 e këndeje 99% ose 98% si kriter është përdorur ofertuesi i përgjithshëm me çmimin më të lirë. Kriteri me çmim më të favorshëm ekonomik është rekomanduar që ky kriter të mos përdoret shumë për shkak të keqpërdorimit, mungesës së zyrtarëve të prokurimit. Tek pjesa e menaxhimit të kontratës dhe vlerësimit të performancës, sistemi i prokurimit elektronik ka një modul specifik ose të veçantë në menaxhim të kontratës. Ai modul është funksional dhe i operueshëm mirëpo nuk përdoret shumë nga zyrtarët e prokurimit sepse kur është dizajnuar kemi pasur dykuptimësi të punës të cilat i takojnë Zyrës së Prokurimit dhe të Financave dhe akoma nuk i kemi definuar qartë procese të punës që lidhen me menaxhim të kontratës që i takojnë Zyrës së Prokurimit ose Sistemeve të Prokurimit dhe Informativ të menaxhimit financiar. Për informacion tuajin KRPP-ja ka bashkëpunuar me USAID për një projekt i cili ka të bëjë me zhvillim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktorëve gjatë implementimit të kontratave të cilin kanë mundësi autoritete kontraktuese dhe zyrtare që merren me menaxhim të projekteve dhe kontratave të përdorin atë sistem moduli. Do bëjmë edhe ridizajnimin e modulit i cili do të jetë shumë i përdorshëm dhe do definohet përgjegjësia mes KRPP-së dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar.

Mërgim Lushtaku: A ka ndodhur që në institucionet publike kanë dhënë vërejtje ose me i vendos operatorët ekonomik në listën e zezë lidhur me tenderët publik? Kemi rastin në Llapushnik një Shkollë është ndërtu, është lënë përgjysmë sepse nuk i është përmbajtur planit ekonomik të projektit. Nëse nuk ka investime dhe listë të zezë a do të ketë mundësi në ligjin e ri vendosja e tyre automatikisht?

Agron Ibishi: Për këtë mandat dhe futjen e listës së zezë të kontraktuesve i takon OSHP-së. Në ligjin e ri do të ketë shumë ndryshime sepse në bazë të ligjit aktual, KRPP-ja ka mandat vetëm për pjesën rregullative dhe të monitorimit të aktiviteteve prokurimit jo të kontratave. Por me futjen në përdorim të sistemit elektronik ne i kemi ndërruar mandatet dhe jemi bërë ofrues të shërbimeve nuk jemi vetëm organ rregullativ dhe monitorues kështu me ligjin e ri duhet të përfshihen shumica e këtyre rekomandimeve që ju po i përmendni.

Blerim Kuçi: KRPP për rekomandime të mospërdorimit të formës së prokurimit me çmimit ekonomikisht të favorshëm për mua është e pamjaftueshme nëqoftëse se nuk bëni lëvizje për trajnimin e zyrtarëve sepse atëherë ne kemi përdorur rreth 97% të kriterit të çmimit të lirë dhe nëse nuk ekziston as kualiteti i mirë i mbikëqyrjes të institucioneve të përfundimit të burimeve atëherë ky kriter i sjell shumicën kompanive në falimentim. Mosfunksionimi i të gjitha mundësive të prokurimit dhe përdorja e vetme e këtij kriteri e prish balancin dhe ekonominë e vendit. Një pjesë të fajit ka edhe forma e mbikëqyrjes ndaj terrenit të punëve. Ne mundemi më shumë të ndikojmë mes jush dhe OSHP-së. Krahasuar KRPP me OSHP nuk ka dallime të mëdha, e vetmja mungesë është se nuk i keni kushtu rëndësi se si të përdoret ky kriter ose aftësimin e zyrtarëve të prokurimit ose anëtarëve nëpër komuna.

Enver Hoti: Unë ndaj respektin për masat që kanë marrë mbi konsolidimin dhe ngritjen e mundësive të proceseve të prokurimit publik. Si shqetësim shpreh se a keni ndonjë statistikë ose të dhëna për kontratat e lidhura mes punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilat bien nën kriterin e papërgjegjshmërisë, çmimit më të lirë se 30%? Nëse kemi vëmendje të shtuar dhe me kujdes në përcjelljen e procesit me siguri do gjenim kontrata më pak se 30% e çmimit nga punëdhënësit. Për OSHP kemi çfarë të flasim herave të tjera sepse nuk është me gjendjen e njëjtë, kemi kontrata të papërgjegjshme, moskontrollim të punëve, realizime që kushtojnë shumë më shtrenjtë se kontratat fillestare. Ka njësi që kushtojnë shumë shtrenjtë në treg dhe ipen me një çmim banal.

Osman Vishaj: Kur kemi marrë masa në rregulloren e re kemi parandaluar që asnjë autoritet kontraktues nuk mundet me porositi sasi të punës më shumë se 30% nëse e ka një plan të dobët.

Enver Hoti: Problemi im nuk qëndron tek sasia, pyetja ime lidhet se nëse zotohen për ndërtim të një projekti investim kapitali më shumë se 50.000 euro dhe organi që e ka vlerësuar bazën e të dhënave me elemente përcjellëse dhe vjen dikush rikuperon me 200.000 euro dhe e merr. Andaj a ka projekte të tilla të cilat lidhen në nivel lokal e qendror dhe punohen me punë shtesë?

Agron Ibishi: Përgjegjësia në çdo planifikim është e organizatës buxhetore ose njësive kërkuese, do të thotë ata e bëjnë planifikimin dhe jo KRRP-ja. Nëse çmimi është jonormalisht i ulët autoritetet kontraktuese e përdorin dhe trajtojnë çmimin joformal të ulët, që është formulë e prokurimit që drejton këtë çështje. Gjithçka është nën autoritete kontraktuese dhe njësive kërkuese, ato e dinë kushtimin e projektit dhe vlerësimin, nuk kemi analizë tjetër.

Shkëlqim Xhema: Pasqyrat financiare prezantohen në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë në gjitha aspektet materiale. Pas opinionit të raportit të auditimit kemi kryer edhe auditimin për menaxhim financiar e të kontrollit nga viti i kaluar. Sa i përket kësaj të fundit ne mund të themi që KRPP-ja ka pasur kontroll të duhura me obligime shtetërore. Sa i përket rekomandimeve të vitit të kaluar dy prej tyre janë zbatuar, 1 ishte pjesërisht e zbatuar dhe 1 e mbyllur nga Zyra e Auditorit. Çështjet e auditimit gjatë vitit 2018 kanë qenë për mosshpalosje të një detyrimi kontingjent në pasqyra financiare, e dyta mosregjistrimi i pasurive jokapitale në sistemin e pasurive. Sa i përket kontekstit gjyqësor, kanë bërë një ankesë në operatorin shtetëror si përfaqësues të institucioneve dhe janë në pritje të aktgjykimit në shkallën e dytë.

Kryetari: Përse nuk e keni bërë detyrimin e kontingjentit?

Osman Vishaj: është një objekt i hershëm para 7 viteve dhe nuk e di as unë kur e kam parë.

Kryetari: çfarë duhet të bëhet me mbyll këtë rekomandim?

Shkëlqim Xhema: Është dashur të prezantohen pasqyrat. Kërkohej edhe me rregullore të pasqyrohen pikat financiare të pasurisë, këtu e kemi një regjistër të brendshëm me të cilin operojnë.

Osman Vishaj: është adresuar sepse gjatë asaj kohe nuk kam qenë këtu, për vitin 2019 mendoj se do jetë e mbyllur si çështje.

Safete Hadergjonaj: Duke parë çështjen e regjistrimeve të problemeve dhe përsëritjen e të gjetura prej vit në vit është diçka që duhet adresuar dhe të mospërsëriten të njëjtat probleme. Prandaj, unë kisha sugjeru që me një bashkëpunim më të mirë dhe me qasje pozitive ti zgjidhni këto probleme. Institucioni apo organizata buxhetore në bazë të rekomandimeve të auditorit me gjetë mundësi mos me u përcjell nga viti në vit sepse janë shumë institucione ndaj të cilave po përcillen të gjeturat e njëjta vit pas viti.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, kryetari konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurorimit Publik për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2018

Kryetari: ia kalojë fjalën Drejtorit të ANJF-së, që të prezantojë raportin financiar për vitin 2018.

Ramadan Gashi: Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka qëllim ofrimin e ndihmës juridike falas në nevojë me iu qas sistemit të drejtësisë dhe në çdo vit kemi pasur kërkesa buxhetore dhe vështirësi në shtrirje por në këto dy vite të fundit jemi në një situatë më të mirë dhe kemi filluar shtrirje edhe nëpër komuna në mënyrë vetanake. Sa i përket kërkesave buxhetore gjithmonë kemi pasur mirëkuptim deri vitin e kaluar dhe tani kemi arritur buxhet për përfaqësim të avokatëve deri në 100.000 euro. Buxheti është shpenzuar sipas planeve që ne kemi bërë pas disa tejkalimeve të vogla në nënkategori. Vlen të theksohet se ne kemi edhe raportin e auditorit i cili është raport pa asnjë të gjetur apo rekomandim.

Astrit Billaca: Zyra jonë ka publikuar raportin dhe agjencia për Ndihmë Juridike Falas paraqet pamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Nuk ka pasur të gjetura.

Kryetari: Këto 23.000 euro shtesa për honorare për çfarë janë paguar. A keni nevojë për punë jashtë orarit?

Ramadan Gashi: Këto shpenzime janë të specifikuara për çfarë janë përdorur. Realisht shumicën e zyrtarëve i kam angazhuar me dy ose më shumë punë dhe kompensohen vetëm me pagën e rregullt kurse jashtë orarit me pagesë shtesë.

Ali Lajçi: Nuk paraqitni gjithmonë kërkesa buxhetore për punë që janë praktikisht të rëndësishme.

Ramadan Gashi: Ne jemi të organizuar në bazë të parimit të gjykatave themelore dhe mbulohe mi me buxhet të Kosovës, por ligji na kërkon shtrirje në tërë territorin e Kosovës. Për këta zyrtarë jemi gjithmonë në kërkim të kërkesës buxhetore por nuk kemi has kontrata të tilla po pasi kemi filluar me donacione, shpresojmë se duhet aprovohet në buxhetin e Kosovës. Ne pa u shtrirë në gjitha komunat nuk mendojmë se kemi arritur të bëjmë punën e duhur.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2018.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2018

Kryetari: ia kalojë fjalën Drejtorit të ARRSHU-së, që të prezantojë raportin financiar për vitin 2018.

Raif Preteni: Buxheti për paga dhe mëditje për 2018 ka qenë 250.122 euro, mallra dhe shërbime 134.495 euro, shpenzime kapitale nuk kemi pasur. Në kategori të shërbimeve komunale janë shpenzuar 6.503 euro. Me kërkesë të Ministrisë së Financave kemi kthyer në buxhetin e Kosovës për paga dhe mëditje shumën prej 33.163 euro. Kursimi ka ndodhur sepse ende nuk është bërë plotësimi i pozitave të lira për shkak të procedurave të rekrutimit ku kemi qenë të detyruar dy-tre herë të rishpallen konkurse për gjetjen e zgjidhjes. Buxheti final për 2018 ka qenë 359.322 euro dhe është shpenzuar 98.6%. Qiraja e objektit është shpenzimi më i lartë në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 42.000 euro të cilat bëjnë pjesë në mbi 31%. Pastaj shifrat e konsumatorëve me 13.000 euro, sigurimi i objektit 6.100 euro. Për vitin 2018 të hyrat e taksave dhe licencimit në vlerë prej 391.130 euro të cilat i ka aneksuar 100%. Përveç atyre të planifikuara ka aneksuar 46.299 euro, prej tyre 39.643 euro nga borxhet e vjetra, 5.000 euro nga gjoba, nga taksat 1600 euro për aplikim për licencë dhe kemi pasur një të hyrë të gabuar në vlerë prej 56 euro.

Shkëlqim Xhema: Tek zbatimi rekomandimeve, për 2017 kanë qenë tre rekomandime të dhëna, vitin e kaluar ka qenë në periudhë të paplanifikuar për shkak të një gabimi që kanë prezantuar vlerën e pagave në buxhetin final. Këtë vit ka pasur përmirësime, problem me zhvlerësim të pasurive në sistem të e-pasurive që është zgjedhur këtë vit. Pos zbatimit të rekomandimeve për këtë vit nuk ka diçka tjetër.

Kryetari: Duke ditur se nuk keni shpenzime të larta unë dua të flas për dy çështje: e para ka të bëjë me shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit që po përbejnë 50% , nuk e di pse duhet bërë kaq shumë udhëtime jashtë vendit? Dhe e dyta qiraja e lartë prej 42.000 euro a është shkak i lokacionit, a mund të kaloni në lokacione më të lira? Ku gjendet lokacioni?

Raif Preteni: Momentalisht gjendemi afër Ministrisë së Arsimit. Qiraja është shqetësuese që disa vite, kemi bërë shpallje publike dhe vendi më i lirë që kemi gjetur është këtu, kurse atëherë kur kemi qenë pronari ka ndërprerë kontratën. Udhëtimet jashtë vendi kanë pasuar vit pas viti, ne kemi anëtarë të vizitave studimore e rregullative që bëhen në rajon dhe në BE. Ne shkojmë në takime sepse në Kosovë nuk paguhemi, kemi pagën asnjë mëditje brenda nuk merr askush. 13.000 euro shpenzime janë për këshilla të konsumatorëve në 7 qendra të Kosovës dhe zgjedhin nga kryetarët e komunave në bashkëpunim me ne për marrjen e vendimeve për ankesa të konsumatorëve. Kanë një mëditje që për tërë vitin që bie dikund në total 13.000 euro.

Ali Lajçi: Borxhet e vjetra që kanë mbetur a keni ndonjë strategji për grumbullimin e dokumentacioneve. Lidhur me qiranë ne edhe vitin e kaluar e kemi ngritur këtë shqetësim për shumat e mëdha të qirave që po paguhen nga buxheti i shtetit dhe kemi kërkuar të evidentohen objektet me pronësi shtetërore për të kaluar institucionet në këto objekte.

Raif Preteni: Në borxhet e vjetra janë në procedura gjyqësore komunat e veriut dhe Shtërpca. Në Mitrovicë nuk janë pranuar vendimet tona pastaj kemi bërë kallëzim penal në gjykata kurse në Shtërpçë jemi në proces gjyqësor. Kurse për procedura gjyqësore kemi kompanitë e tjera të cilat funksionojnë në këtë çështje.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit për vitin 2018.

5. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt 11.03.2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të kësaj Agjencie

Kryetari: Hodhi në votim propozimin e Grupit Punues të Komisionit për caktimin e pagës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Vendosije për Prona

Në bazë të rezultatit të votimit: 4 vota Për, 2 Kundër dhe Asnjë Abstenim, Kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Propozim – Vendim

Për caktimin e pagës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Verifikim dhe Vendosije për Prona

1. Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i caktohet paga në shumën prej 1,362.30 euro, bruto në muaj dhe zbatohet nga data e emërimit të tij nga Kuvendi.
2. Zëvendës-Drejtori i Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i caktohet paga në shumën prej 1,195 euro, bruto në muaj.
3. Paga e Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Propozim-vendimi, paguhet nga buxheti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku